

RREGULLAT E PRANIMIT DHE DORËZIMIT TE PROJEKTIT TE DIPLOMËS

Ju lutemi ndiqni rregullat e mëposhtëm gjatë finalizimit të projektit të Diplomës.

Projekti i Diplomës duhet të dorëzohet në PDF, të printuar në formatin A3, maket dhe prezantim.

1. Rregullat e krijimit të PDF

- a. Krijoni vetëm një file. Mos e ndani projektin në disa file.
- b. Emri i file duhet të jetë “viti i dorëzimit” + “departamenti” + “lënda” + “emri i studenteve”. Këto komponentë duhet të ndahen nga shenja “_”. P.sh nëse i referohemi dorëzimit në vitin 2014, sezoni i verës dhe emri i studentit është Joana Bushi file do të emërtohet: “2014_vere_ark_diploma_joanabushi.pdf”
- c. Kujdes! Asnjë hapësirë nuk është vendosur ndërmjet fjalëve.
[Viti i dorëzimit]2014_[sezoni i verës]vere_[departamenti] ark_[projekti] diploma_[emri i studenteve] joanabushi
- d. Parametrat e file PDF.
 - Font: “embedded”
 - Resolution: 144 dpi ose më tepër
 - Security: duhet të jetë i hapshëm e të printueshëm – i pa bllokuar me password
 - Të tjera: nuk duhet të ketë kufizime në ngjyra, kompresione, etj.
- a. File duhet të jetë jo më i madh se 15 mega byte.
- b. Duhet të kontrolloni me kujdes file nëse është afishuar çdo gjë në mënyrë korrekte pasi ta krijoni këtë
- c. PDF. Duhet ta kontrolloni serish në një kompjuter tjetër (i ndryshëm nga ai ku është krijuar file).
- d. Projekti duhet dorëzuar në këtë renditje:
 - Kapaku/kopertina – Logo e FAU dhe UPT, emërtimet përkatëse të projektit të Diplomës sipas “template” të marre në Departament
 - Përmbajtja – Tabela e fletëve përmbajtëse të projektit
 - Relacioni – Teksti kryesor me një madhësi font-i kryesor 11 points, margins anësore 20 mm dhe margins sipër e poshtë 30mm
 - Projekti i diplomës
 - Posterat 2-4 cope sipas template
 - Pamje të maketit
- e. **Publiciteti:** Nëse do të gjykohej i nevojshëm file do të vihet në dispozicion publikut universitar pa të drejtë kopjimi.

2. Mënyra e dorëzimit: “File” do të dorëzohet në Departament në një CD.

3. Projekti i printuar në formatin Poster

I gjithë projekti duhet të përmbledhet në 2-4 postera në formatin sipas template që mund të shkarkohet në faqen e internetit të FAU (www.fau.edu.al) dhe printohet me ngjyra. Posterat ekspozohen në ambientet e FAU në datën e përcaktuar nga Departamenti.

4. Maketi

Maketi duhet të realizohet në shkallën që gjykoni të përshtatshme për të afishuar detajet e tij. Materialet që mund të aplikohen janë pa limit. Maketi dorëzohet ditën e prezantimit të Diplomës. Kur maketi gjykohej i përshtatshëm, do të ngele prone e departamentit. Në të kundërt maketin mund ta tërhiqni. Maketi ekspozohet në ambientet e FAU në datën e përcaktuar nga Departamenti.

5. Prezantimi

Prezantimi duhet të bëhet në Power Point, Postera dhe Maket. Prezantimi nuk duhet të zgjasë më tepër se 15 minuta. Komisioni gjykon sipas rastit kohëzgjatjen e seancës së pyetjeve.